



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit Univerziteti Prizren Prizren Üniversitesi "UKSHIN HOTI" F. i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	
Pranuar me dt.	30.12.2019
Lyra e pranimit	Nr. i protokollit
507	1-137

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

KËSHILLI I FAKULTETIT

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më 30.12.2019

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 76 paragrafi 1 alineja 1.9 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" (referuar si Universiteti) sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, duke vendosur në lidhje me miratimin e Planit Strategjik të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (referuar si FSHJM), Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani Strategjik i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024.
- II. Plani Strategjik i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024, do të rishikohet çdo vit akademik.
- III. Pjesë përbërës e këtij vendimi është edhe Plani Strategjik i FSHJM-së.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa Plani Strategjik i FSHJM-së fillon të zbatohet nga 1 janari 2020.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një Plani Strategjik të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024, kjo strategji ka për qëllim që të adresojë nevojën, që të precizohen masat dhe instrumentet e FSHJM-së. FSHJM-ja si njësi akademik e Universitetit duhet të ndërmarrë hapa drejt zhvillimit akademik të arsimit të lartë, duke synuar tregun e punës, ndërkombëtarizmin dhe plotësimin e nevojave të shoqërisë në tërësi. FSHJM-ja ka për qëllim që të arrijë të jetë një njësi akademike publike hulumtuese edhe më e suksesshme, e njohur për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtime shkencore të arrira.

Prandaj, mbi këtë bazë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

Këshillit Drejtues
Menaxhmentit
Këshillit të Fakultetit
Të shpallet në ueb¹ dhe
Arkivit

Kryesues i Këshillit të Fakultetit

Prof. Asoc. Dr. Isuf Lushi



¹ Të Universitetit "Ukshin Hoti"